



01-151

	<p><b>Republika e Kosovës</b>          Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p><b>Komuna e Prishtinës</b>          Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	
--	---	--

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-24037/23 dt. 01.02.2023, të pronarëve Iljasa Fazliu, Ibrahim Kuka, Mehdi Begolli, Bekim Vokshi, Muharrem, Selatin, dhe Skender Morina, Izet, Elez dhe Agron Krasniqi, Alban Gashi dhe Nadije Morina-Kuçi nga Prishtina dhe investitorit N.T.N. “Miri” sh.p.k. nga Prizreni, me përfaqësues Xhafer Kastrati nga Malisheva, dhe “Ada Consulting Group” sh.p.k. nga Prishtina, me përfaqësues Avni Kastrati nga fshati Buroj, Komuna Skenderaj, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, ndërtuar në kuadër nënbloqeve urbane “C-2-5” dhe “C-2-7” të tërësisë urbane “C” të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, në rrugët “Elbasani” dhe “Xhim Xhema” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 10.10.2023, lëshon këtë:

### CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

- I. I LEJOHET** pronarëve Iljasa Fazliu, Ibrahim Kuka, Mehdi Begolli, Bekim Vokshi, Muharrem, Selatin, dhe Skender Morina, Izet, Elez dhe Agron Krasniqi, Alban Gashi dhe Nadije Morina-Kuçi nga Prishtina, me investitor N.T.N. “Miri” sh.p.k. nga Prizreni, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810613944, me përfaqësues Xhafer Kastrati nga Malisheva, dhe “Ada Consulting Group” sh.p.k. nga Prishtina me certifikatë të regjistrimit ARBK 810794215, me përfaqësues Avni Kastrati nga fshati Buroj, Komuna Skenderaj, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-24037/23 dt. 01.02.2023, përdorimi i kompleksit të ndërtesave shumëbanesore me afarizëm, të emërtuara si “Lam. 2” me etazhitet 2B+P+11ET dhe “Lam. 3” me etazhitet 2B+P+11ET, të ndërtuara sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-98297/17 dt. 06.11.2017, në kuadër të nënbloqeve urbane “C-2-5” dhe “C-2-7” të tërësisë urbane “C” të Planit Rregullues “Prishtina e Re-zona Perëndim” konkretisht në parcelën kadastrale nr. 10174-1, ZK Prishtinë.
- II.** Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugët “Elbasani” dhe “Xhim Xhema” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 10, 12,62, 64, 66, 68, 70, 72, 74, 76, 78, 80, 82, 84, 86 dhe 88 në Prishtinë, dhe të njëjtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtim dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.
- III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësisve të tyre në evidencat e regjistrit kadastral.



IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

### Ar sy e t i m

Pronarët/Aplikuesit Iljasa Fazliu, Ibrahim Kuka, Mehdi Begolli, Bekim Vokshi, Muharrem, Selatin, dhe Skender Morina, Izet, Elez dhe Agron Krasniqi, Alban Gashi dhe Nadije Morina-Kuçi nga Prishtina dhe investitori N.T.N. "Miri" sh.p.k. nga Prizreni, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810613944, me përfaqësues Xhafer Kastrati nga Malisheva, dhe "Ada Consulting Group" sh.p.k. nga Prishtina me certifikatë të regjistrimit ARBK 810794215, me përfaqësues Avni Kastrati nga fshati Buroj, komuna Skenderaj, me kërkesën me 05 Nr.391/02-24037/23 dt. 01.02.2023, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesat shumë banesore me afarizëm, të emëtuara si "Lam. 2" me etazhitet 2B+P+11ET dhe "Lam. 3" me etazhitet 2B+P+11ET, të ndërtuar në kuadër të nënblloqeve urbane "C-2-5" dhe "C-2-7" të tërësisë urbane "C" të Planit Rregullues "Prishtina e Re-zona Perëndim" konkretisht në parcelën kadastrale nr. 10174-1, ZK Prishtinë, sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore Ndërtimore 05 Nr. 351/02-98297/17 dt. 06.11.2017 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë, me referencë 09 Nr. 391/02-269668/22 dt. 25.01.2023, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njoftimin mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuessit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të ndërtesës, nga udhëheqësi i punishtes Skender Loshi; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Sheptim Musliu; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Skender Loshi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Gresa Qorri; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Agim Kastrati; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Arton Hetemi; Raportin e përfundimit të punëve për mbrojtje nga zjarri, nga Hesat Guri, Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licencuar per kryerjen e matjeve Xhavit Fetahu me nr. të licencës 75;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:



Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesat shumë banesore me afarizëm mund të përdoren, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shumë banesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI

**Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet:** Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 391/02-24037/23 DT. 10.10.2023**

Zyrtari,  
Berim Osmanaj

Udhëheqëse e Sektorit,  
Nazife Krasniqi



